



Shkodër, 13.05.2019

Kërkesë për ofertë materiale kancelarie

Pozicioni: Subjekt tregtar materiale kancelarie
Titulli i projektit: “Youth WAVE for Human Rights”
Afati i përfundimit të aplikimit: 20 Maj 2019

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Youth Wave for Human Rights” zbatohet në Shkodër në kuadër të Projektit “Të rinjtë në Shqipëri për të Drejtat e Njeriut” i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga World Vision në bashkëpunim me Rrjetin e të Rinjve Jugoro-Lindor. Ky projekt ka për qëllim aftësimin dhe fuqizojmin e të rinjve për të ndërtuar komunitete miqësore dhe respektuese ndaj të drejtave të njeriut dhe përfshin zhvillimin e një sërë aktivitetesh që i shërbejnë arritjes së këtij qëllimi.

2. Qëllimi i kontratës

Përcaktimi i materialeve kancelarie të nevojshme për organizaten, me sasinë specifike të paracaktuar në këtë kërkesë për ofertë.

3. Roli dhe përgjegjësitë e aplikantit/ofertuesit

Shitësi i materialve kancelarie ka rolin furnizues tek Blerësi (Organizata Gruaja tek Gruaja) me materialet e paraqitura në tabelë, si më poshtë.

- Ai duhet t'i dorëzojë sendet Blerësit (organizatës), në përputhje me specifikimet në Tabelën bashkangjitur, në adresën e Blerësit, në përputhje me periudhën e dorëzimit, që do të caktohet në kontratën specifike me aplikantin fitues, sipas kërkesave të organizatës.
- Nëse sendet kanë shtesa, aksesore apo fryte, deri në datën e shitjes, Shitësi duhet t'i dorëzojë ato sëbashku me sendet.
- Shitësi nuk lejohet të zevendësojë sendet apo të ofrojë sende të ndryshme, qoftë dhe të ngjashme me sendet e kërkuar nga Blerësi, përveç kur ka marrë një miratim paraprak me shkrim nga ky i fundit.
- Shitësi është përgjegjës për të metat e sendeve të shfaqura pas pranimit të tyre nga ana e Blerësit, përfshirë por pa u kufizuar në të meta lidhur me materialin, me transportimin ose ambalazhimin e sendeve, të cilat shfaqen pas një kohe përdorimi, brenda së cilës normalisht sendet do duhet të ishin efektive dhe të përshtatshme për përdorimin e posacëm të tyre, edhe pas Periudhës së Garancisë.

4. Kohëzgjatja e kontratës

- Aktiviteti nis menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

- Cdo dorëzim final duhet të jetë i përfunduar deri me datën 31 Dhjetor 2019.

5. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

- Disponimi i materialeve cilësore që kanë të përfshirë një periudhë garancie.
- Të respektojë afatet kohore që do të përcaktohen në kontratë

6. Dokumentacioni i nevojshëm

- Oferta financiare.
- Ekstrakt QKR;

7. Pagesa

Mënyra e pagesës do të kryhet varësisht sipas dhënies në dorëzim të mallrave, duke i lidhur ato me objekte të dorëzuara.

Procedura e prokurimit ka një fond limit prej 171'161 (njëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) Lekë. Subjekti i interesuar për t'iu përgjigjur ftesës për ofertë duhet të paraqesë ofertën e tij pranë organizates, duke përdorur tabelën si më poshtë.

Nr	Lloji	Njesia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Cmimi Total
1	Leter A4	Rizma	36		
2	Boje printeri DCP7055	Cope	10		
3	Dosje A4	Cope	200		
4	Stilolapsa	Cope	200		
5	Blllok shenimesh	Cope	200		
6	Kartona Color	Cope	252		
7	Leter flipchart	Cope	20		
8	Markera mono/color	Cope	80		
	Total				

8. Aplikimi

Aplikimi/oferta duhet të dërgohet brënda datës 20.05.2019 me email në adresën: gruajatekgruaja@gmail.com.